

SPECIFIKIME TEKNIKE

Modeli :Eskavator (skrep) me goma

Sasia: 1(nje) copë

Emërtimi

Specifikimi

- | | |
|--|---------------------------|
| 1. Viti i prodhimit | Jo më parë se 2020 |
| 2. Gjëndja e mjeteve | Të rinj (0 orë pune) |
| 3. Motorri | Min 70 kW |
| 4. Karburanti | Naftë |
| 5. Trasmisioni | Semi-automatik |
| 6. Kollona e pasme | Teleskopike |
| 7. Sistemi i komandimit | Mund të jetë dhe mekanike |
| 8. Sistemi i hapjes se krahëve | Hidraulike |
| 9. Kova e përparme e hapëshme. | |
| 10.Mjet të jetë i paisur me 2 kova gërrmimi me keto përmasa:
Të ketë një kovë 60 cm dhe një 40 cm | |
| 11.Me 4 goma 2 gomat e përparme te vogla , 2 të pasmet të mëdha | |
| 12.Skrepi të ketë të instaluar sistemin standart të vendosjes së cekicit dhe turjelës shpuese. | |
| 13.Të jetë i pajisur me kondicioner (I përshtatshëm për drejtuesin pasi puna është në terrene të veshtira , analizuar edhe kohën në punë dhe temperaturat e larta.) | |
| 14.Kompleti rezerv (Trekëndësh paralajmërues,kuti e ndihmës së shpejtë) | |

ARGUMENTIM

- ❖ **Pika 1**-Është përcaktuar që mallrat objekt prokurimi të jenë të reja ,të papërdorura,ku viti i prodhimit të jetë jo më parë se 2020 (që në fakt bëhet fjalë për një periudhë të arsyeshme që përfshin 3(tre) vite prodhimi 2020,2021,2022). Kjo është kërkuar që mjetet e kërkuara ,të jenë të prodhimit të viteve të fundit, në mbështetje edhe të pikës 8/b të V.K.M. nr.633 datë 16.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike” në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe direktivave të BE për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis,në varësi të kategorizimit të mjeteve, sipas peshës dhe kohës së përdorimit.Këto mallra bëjnë pjesë në gjeneratën e re në drejtim të ekonomisë së karburantit,sigurisë dhe qëndrueshmërisë teknike,efiçensës dhe efikasitetin në koston e përgjithshme,sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit si edhe në rregullimin dhe emëtimin e gazrave në natyrë.
- ❖ **Pika 4**-Për këtë procedure për llojin e karburantit është zgjedhur lënda djegëse “Naftë” ,për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzin është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë,gjë që ndikon drejtëpërdrejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%.Arsye tjetër se përse për këtë procedure është zgjedhur lënda djegëse “Naftë” është dhe tipologjia e mjetit. Duke qënë se janë mjete të rënda dhe janë të presupozuara të punojnë në terrene te vështira dhe kerkojnë një force motorrike të konsiderueshme është përzgjedhur lënda djegëse “Naftë” dhe për arsye te fuqisë kalorifike qe ajo ka (më të lartë se benzina). Gjithashtu duke testuar edhe tregun përgjithësisht për mjetet e rënda lënda djegëse është “Naftë”. Motorri me naftë është më i thjeshtë , ka më shumë qëndrueshmeri dhe jetëgjatësi më të lartë.
- ❖ **Pika 10**- Janë kërkuar kova gërrmimi me dimensione të ndryshme për shkak të llojit të punës që ato do kryejn, ngarkim/germim dheu.
- ❖ **Pika 11**-Për shkak të kompleksitetit te punëve në zona të ndryshme janë kërkuar që skrepat te jenë me goma.

Dokumenta shoqeruese te mjetit

1. Te jetë i pajisur me dokumentacion regjistrimi ku përfshihen (leje qarkullimi,targa,taksa)

2. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësi ndaj palëve të treta (TPL).
3. Manual përdorimi i përgjithshëm dhe instruksione teknike të mjetit.

GARANCIA

- Garancia _____ **24** _____ *muaj*.
- Afati i lëvrimit të mallit , jo më shumë se _____ **60** _____ *ditë* nga data e lidhjes së kontratës.
- Afati i kolaudimit të jetë (*prova, testime në terren*) jo më shumë se 7 ditë kalendarike ose 5 dite pune.



Foto ilustruese/orientuese